

1 E enjte, 19 maj 2022

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari u paraqit përmes videolidhjes]

4 --- Fillon në orën 09.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjesi.

7 Z. Sekretare, ju lutem paraqisni lëndën

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar
9 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-05, Prokurori i
10 Specializuar kundër Salih Mustafës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit znj. Sekretare.

13 Në fillim të prezantohen të pranishmit.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës,
15 mirëdita të gjithëve. Ekipi i Prokurorisë përfaqësohet sot nga
16 Silvia D'Ascoli, Ndihmësprokurore; Julie Mann, Menaxhere e
17 Lëndës; dhe nga unë Cezary Michalczuk, Prokuror.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Faleminderit.

20 Mbrojtësja e Viktimave.

21 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës,
22 mirëdita të gjithëve. Viktimat pjesëmarrëse përfaqësohen sot
23 nga unë Anni Pues, si Mbrojtëse e Viktimave. Faleminderit.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Avokati Mbrojtës e keni fjalën.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëdita të nderuar Gjykatës.

3 Mbrojtja përfaqësohet sot nga unë, Julius von Bone; Betim

4 Shala Bashkëmbrojtësi; Fatmir Pelaj, hetues dhe përkthyes; dhe

5 z. Avni Mehmeti, hetues.

6 Me videolidhje nga bashkohet z. Mustafa.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit.

9 Z. Mustafa na dëgjoni në rregull?

10 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e nderuar

11 Gjykatëse.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për

13 procesverbal ky proces zhvillohet përpara Trupit Gjykses numër

14 I.

15 Trupi Gjykses rikujton se z. Mustafa kishte shprehur

16 synimin për të bërë deklaratë pa betim në përputhje me

17 rregullën 141(1) të Rregullores. Jo më larg se data 12 prill

18 2022, z. Mustafa, përmes Avokatit të Mbrojtjes e kishte

19 konfirmuar gatishmërinë për t'ju përgjigjur pyetjeve të Trupit

20 Gjykses nëse do të kishte, sigurisht në vartësi edhe të të

21 drejtave të tij për të mos folur, për të qëndruar i heshtur.

22 Z. Mustafa, arsyeja pse Trupi Gjykses dëshironte t'ju

23 bënte pyetje ishte dhe ndër të tjera për t'u përpjekur për të

24 sqaruar se çfarë ka ndodhur aso kohe në prill të vitit 1999

25 dhe cili ka qenë roli juaj, nëse keni pasur ndonjë rol në

1 kuadër aktakuzës së konfirmuar. Pyetjet që Trupi Gjykses do
2 t'jua kishte bërë, duhet të ishin parë nga ky këndvështrim.

3 Përmes parashtrimit të protokolluar me numër 410, i cili
4 fatkeqësisht është bërë më pak se 24 orë përpara seancës së
5 sotme, Mbrojtja ka informuar se z. Mustafa e ka rimenduar
6 qëndrimin e tij dhe nuk do të japë deklaratë pa betim dhe as
7 nuk do t'u përgjigjet pyetjeve të Trupit Gjykses.

8 Rrjedhimisht, deklarata pa betim, sipas rregullës 142 të
9 Rregullores dhe procedurat përkatëse, nuk do të zhvillohen.

10 Z. Avokat, keni diçka për të thënë lidhur me këtë, nëse
11 ka?

12 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuara Gjykatëse, një gjë të
13 cilën do të doja ta thosha është se po ta kishim ditur këtë
14 ndryshim të qëndrimit më përpara do ta kishim dorëzuar
15 parashtrimin më përpara. Por, kështu ndodhi. Këtë desha të
16 them lidhur me këtë aspekt.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Faleminderit z. Avokat.

19 Megjithatë, po e zhvillojmë këtë seancë sot sepse Trupi
20 Gjykses do të lëshojë disa urdhra gojarisht.

21 Urdhri i parë kërkon që të kalojmë në seancë private.

22 Znj. Sekretare, ju lutem të kalojmë në seancë private.

23 [Seancë private]

24 [Seancë private teksti i fshirë]

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24 [Seancë e hapur]

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

1 jemi rikthyer në seancë të hapur.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Urdhri i dytë gojarisht është ky.

5 Z. Avokat, Trupi Gjykues supozon se ju nuk keni më asgjë
6 tjetër për të paraqitur dhe rrjedhimisht, mbyllja e paraqitjes
7 së provave nga Mbrojtja është parashikuar që të ndodhë më datë
8 26 maj 2022.

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Sipas vlerësimit tonë, kështu
10 është vërtetë. Ka një gjë të vogël të cilën ende po e
11 mendojmë, por besoj se do të jetë data 26 maj, data 26 maj.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
13 mund të na thoni ndonjë gjë më shumë për këtë gjënë e vogël?
14 Sepse po i afrohem fundit dhe duhet të bëjmë planifikim. Mu
15 duk sikur vura disa hiqe dyshimi në tonin e zërit.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Me 99 për qind me datë 26 do ta
17 mbyllin paraqitjen e lëndës tonë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
19 Avokat, ne e kemi caktuar datën, por gjithsesi, ju kërkojmë
20 nëse -- sa më shpejt ta merrni vesh, aq më shpejt të na
21 informoni. Mos prisni derisa të afrojnë data dhe të na thoni.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Pa tjetër. Do të veprojmë kështu
23 si thoni ju. Por, supozojmë se do të jetë data 26 maj.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Ajo që thashë nuk kishte të bënte me mbylljen e çështjes,
2 por nëse donit që t'i paraqisnit Trupit Gjykues ndonjë kërkesë
3 lidhur me këtë. Për këtë e kisha fjalën. Ju lutem të na
4 informoni sa më shpejt.

5 Në rregull, atëherë.

6 Po i drejtohem ZPS-së sepse ky urdhër gojarisht i
7 drejtohet ZPS-së.

8 Trupi Gjykues vëren gjithashtu se rregulla 127(2) i
9 Rregullores parashikon se përveç se urdhërohet ndryshe nga
10 Trupi Gjykues pas paraqitje së provave nga Mbrojtja dhe
11 provave nga Trupi Gjykues nëse ka, ZPS-ja me lejen e Trupit
12 Gjykues mund të paraqesë kundërprova bazuar me prova shtesë
13 nga Mbrojtja, gjithashtu objekt i lejes së Trupit Gjykues.

14 Duke pasur parasysh se Trupi Gjykues është ende duke
15 kuvenduar, nëse do të paraqesë vetë prova apo jo në përputhje
16 me rregullën 132 të Rregullores, Trupi Gjykues i kërkon ZPS-së
17 në këtë moment që të dorëzojë kërkesën e vet për të paraqitur
18 prova, më falni, kundërprova nëse ka brenda të premtes, më
19 falni, deri brenda të martës 24 maj 2022. Ndërsa përgjigjet,
20 nëse do të ketë nga Mbrojtja dhe Mbrojtësja e Viktimave brenda
21 të premtes, 26 maj. Dhe nëse miratohet leja dhe nëse do të
22 ketë seancë për prova të tilla, Mbrojtjes do t'i kërkohet që
23 të dorëzojë një kërkesë të ngjashme për prova shtesë nëse do
24 të ketë.

25 Nëse ZPS-ja dëshiron që të paraqesë prova shtesë, në

1 formë të kundërprovave pas ndonjë provë që do të paraqitet nga
2 Trupi Gjykses në përputhje me rregullën 132 të Rregullores,
3 duhet të bëhet e ditur sa më shpejt pasi Trupi Gjykses t'i
4 ketë paraqitur këto prova.

5 Këtu mbyllet ky urdhër i dytë i lëshuar gojarisht.

6 Sa i takon tani kalendarit të seancave, nesër paradite,
7 nuk do të kemi seancë, natyrisht, do të shtoja unë. Javën e
8 ardhshme, po kështu nuk do të zhvillohen seancat. Dhe
9 kalendarit i seancave për muajin qershor do t'ju komunikohet
10 përmes NJAGJ-së. Mirëpo, palët dhe Mbrojtësja e Viktimave
11 duhet që të qëndrojnë në dispozicion për të parën, të dytën
12 dhe të tetën ditë të qershorit, si data të mundshme për
13 seanca.

14 Ajo që mendohej se do të ishte një ditë e plotë me
15 seancë, është duke iu afruar fundit. Por, përpara se ta
16 mbyllim, dëshiroj të pyes palët apo Mbrojtësen e Viktimave
17 nëse kanë diçka për të ngritur.

18 Z. Prokuror.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, asgjë
20 tjetër nga ana jonë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Faleminderit.

23 Mbrojtësja e Viktimave.

24 ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës, asgjë.

25 Faleminderit.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Avokati i Mbrojtjes.

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës, nuk kemi
4 asgjë tjetër për të ngritur.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
6 rregull. Më bëhet qejfi që ju shoh përsëri në sallë.

7 Në rregull, atëherë. Falënderoj palët dhe Mbrojtësen e
8 Viktimave për praninë e tyre sot.

9 Dëshiroj të falënderoj përkthyesit, ekipin audioteknik,
10 ekipin e sigurisë dhe të gjithë të tjerët që na kanë ndihmuar
11 sot.

12 Këtu ndërpritet seanca.

13 --- Seanca mbyllet në orën 09.43.

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25